



## Departamenti i Prokurimit

Prishtine: datë, 16.09.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.09.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “NTSH KOSLABOR” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material shpenzues mjekësor”, me Nr. të Prok: **616 21 3547 121** nxjerr:

### V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “NTSH KOSLABOR” e datës 15.09.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit titull “Furnizim me material shpenzues mjekësor”, me Nr. të Prok: **616 21 3547 121**, kundër [Njoftimit për dhënie të Kontratës] të AK –së, të datës 13.09.2021 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .

1. *[Vërtetohet]* vendimi i AK i publikuar me datë: 13.09.2021;
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te respektoj Vendimin e datës 13.09.2021*
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsyetim

Pretendimet tuaja janë te pa bazuara për arsye të vijim:

-E para ju jeni ndërlidhur me kërkesat tuaja për sqarime në fazën e publikimit të njoftimit për kontratë, të cilat nuk janë trajtuar si të pranueshme nga Autoriteti Kontraktues dhe kjo nuk ka asnjë rëndësi për fazën e aktivitetit ku jemi tani, sepse ju keni dorëzuar tender sipas kërkesave të FDT-së dhe në bazë të tyre AK-ja ka për obligim të bëjë vlerësimin e tenderit, si që edhe ka vepruar. Pra nuk ka asnjë bazë ligjore për ndërrim të kërkesave, përkundrazi është plotësisht e pa ligjshme tendenca për t'i ndryshuar. Besoj se këtë e dini edhe ju, por vetëm ua rikujtoj. Poashtu kriteri i çmimit më të ulët vlen si çdoherë për tenderusin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, pra për tenderuesin që ka plotësuar të gjitha kërkesat, duke përfshirë edhe dëshminë e autorizimit.

Bazuar në sqarimin paraprak pretendimet dhe rekomandimet tuaja janë të pa bazuara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe si të tilla refuzohen.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lartë ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit